

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 113, datë 28.05.2026

PËR
RINOVIMIN E LICENCËS SË Z. ARTAN KALECI SI VLERËSUES DËMESH NË
SIGURIME

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 4, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, të ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, rregullores nr. 198, datë 29.12.2020 “Për kualifikimin profesional dhe edukimin në vazhdim”, rregullores nr. 35, datë 27.03.2019 “Për organizimin dhe funksionimin e testimit të njohurive të kandidatëve që aplikojnë për licencë/rinovim licence në Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” si dhe rregullores nr. 85, datë 03.07.2017 “Mbi licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së vlerësuesit të dëmeve në sigurime”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Rinovimin e licencës së z. Artan Kaleci, si vlerësues i dëmeve materiale motorike dhe dëmeve shëndetësore, në klasat e jojetës: sigurim i aksidenteve dhe shëndetit, sigurime motorike.**
- 2. Licenca shoqërohet me deklaratën personale të nënshkruar nga vlerësuesi, sipas formatit bashkëlidhur.**
- 3. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Saimir TOLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV

Adela XHEMALI